



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE

Njoftim

Thirrje për aplikim për përfshirjen e kualifikimeve për të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve për Arsimin dhe Formimin Profesional

Drejtuar: Ofruesve publikë dhe jopublikë të AFP-së në Republikën e Shqipërisë

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), në mbështetje të Ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 10247, datë 04.03.2010 “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”, i ndryshuar, të VKM-së nr. 673 datë 16.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e AKAFPK-së”, të VKM-së nr. 427, datë 26.06.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve për arsimin dhe formimin profesional”, shpall hapjen e fazës së aplikimeve për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve për arsimin dhe formimin profesional.

Synimi i thirrjes

Synimi i kësaj thirrje është përcaktimi i niveleve të kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës, me qëllim përfshirjen e tyre në nivelet përkatëse të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve për arsimin dhe formimin profesional.

Afati për aplikim

Thirrja është e hapur nga data 26 nëntor 2024 deri më datë 15 dhjetor 2024.

Kush mund të aplikojë?

Në këtë thirrje mund të aplikojnë të gjithë ofruesit publikë dhe jopublikë që janë të licencuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, nga autoriteti që mbulon fushën përkatëse të përgjegjësisë për të ofruar kualifikime, të jetë i autorizuar për të ofruar kualifikimin për të cilin kërkohet përfshirja sipas nivelit të KSHK-së, përpara fillimit të ofrimit të kualifikimit, kualifikimi për të nxënit gjatë gjithë jetës për të cilin aplikon të ketë jo më pak se 125 (njëqind e njëzet e pesë) orë, si dhe të jenë

kualifikime profesionale të regjistruara me njësi të nxëni në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve Profesionale.

Si mund të aplikojnë?

Ofruesit publikë dhe jopublikë që ofrojnë kualifikime në Republikën e Shqipërisë dhe duan të aplikojnë duhet të plotësojnë formularët A, B dhe C në linkun e mëposhtëm:

<https://www.akafp.gov.al/blog/2024/11/13/perfshirja-e-kualifikimeve-te-ngjj-ne-kshk/>

Shënim:

Përpara aplikimit ju duhet të paraqiteni pranë zyrave të AKAFPK-së, në adresën: rruga “Mustafa Lleshi”, Godina e Thesarit, Kati i tretë, Tiranë, **për të tërhequr faturën për arkëtim** për trajtimin, shqyrtimin dhe përfshirjen e kualifikimeve në KSHK (referuar pikës 14, kreu V i VKM-së nr. 427, datë 26.06.2019 *“Për miratimin e kriterëve dhe të procedurave për përfshirjen e kualifikimeve për të nxënit gjatë gjithë jetës sipas niveleve të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve për arsimin dhe formimin profesional”*).

Për çdo paqartësi, ose informacion shtesë, ju lutem na shkruani në email-in: info.akafp@akafp.gov.al.